## Konsultori i para lindjes ju pret

Për :

- t'ju dëgjuar, përgjigjur pyetjeve tuaja, t'ju dhënë këshilla....
- t'u kujdesur për shëndetin tuaj (tensionin, peshën...)
- t'u kujdesur për vitalitetin dhe rritjen e bebes;
- të realizuar kontrollet gjinekologjike;
- të përcaktuar kontrollet për mbrojtjen dhe depistimin të propozuara gjatë shtatzënisë
- të t'ju dhënë vaksinat kundër difterisë, tetanosit dhe kollës së mirë.

### Kalendari i vizitave të propozuara

| Shtatzënia e parë: | Shtatzënia e dytë dhe + | Ekografi |
|---|---|---|
| 6 – 8 javë | 6 -8 javë | |
| 13 javë | 13 javë | 12 javë |
| 17 – 18 javë | 19 javë | |
| 23 javë | 23 javë | 22 javë |
| 27 – 28 javë | 28 javë | |
| 33 javë | 33 javë | 32 javë |
| 36 javë | 37 javë | |
| 38 javë | | |
| 39 javë | 39 – 40 javë | |
| 40 javë | | |



# KONSULTIMI I PARA LINDJES

## PYETJE NË LIDHJE ME SHTATZËNINË TUAJ ?

REDAKTOR PËRGJEGJËS
Benoît PARMENTIER

REALIZIMI
ONE

D/2017/74.80/33



### Konsultimi para lindjes pranë jush.....

Për të njohur adresën dhe oraret e konsultores së para lindjes më afër jush, vizitoni faqen web www.one.be ose telefononi në Administratën nënrajonale të ONE-së të provincës tuaj :

Administrata qëndrore : 02 542 12 11 - info@one.be

Bruxelles : 02 511 47 51 - asr.bruxelles@one.be
Brabant wallon : 02 656 08 90 - asr.brabant.wallon@one.be
Hainaut : 065 39 96 60 - asr.hainaut@one.be
Liège : 04 344 94 94 - asr.liege@one.be
Luxembourg : 061 23 99 60 - asr.luxembourg@one.be
Namur : 081 72 36 00 - asr.namur@one.be

ONE – OFFICE DE LA NAISSANCE ET DE L'ENFANCE
Chaussée de Charleroi 95, B-1060 Bruxelles
Tél. : +32 (0)2 542 12 11 / Fax : +32 (0)2 542 12 51
info@one.be - ONE.be

Office de la Naissance et de l'Enfance - ONE
@ONEnfance

ONE.be

FÉDÉRATION WALLONIE-BRUXELLES
Loterie Nationale
Avec le soutien de la Fédération Wallonie-Bruxelles et de la Loterie Nationale

SETIS W
Traduction: SETIS Wallonie

Albanais

ONE – OFFICE DE LA NAISSANCE ET DE L'ENFANCE

ONE ju shoqëron

# KONSULTIMI I PARA LINDJES

## PYETJE NË LIDHJE ME SHTATZËNINË ?



ONE.be

## Një shoqërim prej specialistëve

Konsultori i para lindjes është një vend i hapur për të gjithë ata që do të behen prindër..

Ai ndodhet në lagjen tuaj ose në spital.
Ju do të mirëpriteni atje nga një ekip specialistësh të përgatitur për monitorimin e shtatzënisë:

Mami, mjek i përgjithshëm ose gjinekolog dhe punonjësi mjekësor-social.

Ata do t'ju shoqërojnë në planin mjekësor e social gjatë gjithë periudhës së shtatzënisë.
Shërbimet e konsultorit janë falas, pas ndërhyrjes financiare të mutuelle-it tuaj, të CPAS ose të ONE-së dhe në dispozicion të të gjithëve!





## Një dëgjim dhe mbështetje personale



Punonjësi mjekësor-social (PMS) i ONE-ës * do t'ju propozojë një ose disa takime, gjatë një vizite në shtëpi ose një konsultimi.

Gjatë takimit të parë, ju do të merni librin « **Të bëhesh prind** ».

Ky libër ju informon për shërbimet e ofruara, në përgjigjje të nevojave të fëmijëve dhe prindërve.

PMS është i disponueshëm për t'ju shoqëruar gjatë përiudhës së shtatzënisë dhe për të diskutuar me ju shqetësimet tuaja :

→ Ushqimi, lodhja, puna, përgatitja e lindjes dhe dhënia gji, vaksinimi, formalitetet administrative, të drejtat sociale...

Ai do t'ju informojë, gjithashtu, për aktivitetet e organizuara për konsultimet tuaja të para lindjes:

→ Përgatitja e lindjes dhe dhënia gji, seanca informacioni, mbështetje për ndërprerjen e pirjes së duhanit .....

*Organizëm publik i varur nga Federata Walloni-Bruksel

## Një kujdes mjekësor cilësor

Ekipi i konsultimeve do të kujdeset për ecurinë e shtatzënisë, të shëndetit tuaj dhe atë të bebes suaj.

Ju do të informoheni për të gjitha masat higjenike dhe parandaluese që duhen ndjekur me qëllim që shtatzënia të shkojë mirë.

Tre ekografi për shtatzëninë do të bëhen, përveç konsultimeve.

Gjatë vizitës tuaj të parë, ju do të merni « **Librin e nënës** », ditar i shtatzënisë.

Ruajeni atë me kujdes! Ai do të shërbejë si lidhje midis të gjithë specialistëve të shëndetit që do t'ju shoqërojnë gjatë këtyre 9 muajve,dhe do të jetë një burim i vlefshëm informacioni.

### Në rast vështirësish?

Specialistët pranë jush do t'ju shoqërojnë në spital nëse një problem i shtatzënisë kërkon një mendimin të specializuar.
Konsultuesi i para lindjes do t'ju drejtojë në këtë rast në spitalin e rekomanduar që gjendet në rajonin tuaj ose në spitalin e zgjedhur nga ju.
Në rast sëmundjeje, ju mund të thërrisni, gjithashtu, mjekun tuaj të familjes.

